

MUHARREM DEZHGIU

**NACIONALISTËT MATJANË NË LUFTËN  
PËR ÇLIRIM KOMBËTAR  
(1939-1944)\***

Të gjithë ato forca apo individë që u udhëhoqën nga ideja e çlirimit kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore do të identifikohen, në këtë trajtesë, me emrin nacionalistë. Pra, nacionalistët matjanë përfshijnë të gjitha ato forca e resurse njerëzore, që me veprimet e qëndrimet e tyre i kontribuan çështjes së çlirimit të Shqipërisë dhe më tej, çlirimit kombëtar.

Pushtuesi italian, së bashku me dislokimin e forcave dhe të teknikës ushtarake në Shqipëri, ushtroi një propagandë intensive, për t'i larguar shqiptarët nga ballafaqimi me të. Veç të tjerave, ai mori masa me synimin, që qëndrimi i shqiptarëve të mos merrte nxitje nga stomaku për të reaguuar kundër pushtuesit.

Megjithatë, ndryshimet e dinamikës së luftës botërore, sollën ndryshime të pashmangshme edhe në raportet midis pushtuesit italian dhe shqiptarëve. Shtysën fillestare për qëndresën antifashiste, shqiptarët e morën nga vetëdija kombëtare, e cila ishte edukuar tek ta gjatë jetës së shkurtër të funksionimit të shtetit kombëtar shqiptar, para pushtimit të vendit.

Pesë ditë pas pushtimit të Shqipërisë, Çiano do të shënonte në ditarin e tij se disa shqiptarë, veçanërisht nxënës të shkollave të mesme, e kishin të vështirë ta ngrinin dorën për përshëndetjen romane, ndërsa dikush e refuzonte hapur ta bënte kur e ftonin shokët e tij.<sup>1</sup> Një muaj më vonë ai do të shprehej se “ekziston një trazim i madh në sferat intelektuale të Shqipërisë”<sup>2</sup>. Kështu, në listat e Drejtorisë së Policisë për vitin shkollor 1939-1940, midis shumë nxënësve që përjashtoheshin nga

---

\* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore me temë: “Mati - djepi i historisë dhe i kulturës”, organizuar nga Instituti i Historisë, Tiranë dhe Shoqata Mati, Tiranë, 11 qershor 2010.

<sup>1</sup> Gaetano Çiano, *Ditari i Kontit Ciano (Shqipëria) (1937-1943)*, Tiranë: “Albinform”, 1994, f. 42.

<sup>2</sup> *Po aty*, f. 46.

shkolla, “për pjesëmarrje në manifestime antifashiste”<sup>3</sup>, ishte edhe emri i matjanit, Beqir Minxhozi.

Shumë studentë shqiptarë që studionin në Itali, u ndëshkuan nga Komisioni Qendror i Internimeve, se “zhvillonin propagandë subversive”<sup>4</sup>. Midis tyre ishin dhe matjanët Hasan Farrici e Xhemal Punavia, të cilët, edhe pse ishin nën vëzhgimin e rreptë të superstrukturës së shtetit fashist, shfaqnin hapur qëndrimin kundër fashizmit, duke treguar një ndjenjë të lartë atdhedashurie.

Dihet se në marrëdhëniet italo-shqiptare të paraluftës, spikatën ato në fushën ushtarake, sidomos në frekuentimin e shkollave ushtarake italiane prej studentëve shqiptarë. Në vitin 1938 kishin mbaruar shkollat ushtarake italiane 130-140 studentë shqiptarë dhe vazhdonin të studionin mbi 180 të tjerë<sup>5</sup>. Ndryshimi i raporteve politike shqiptaro-italiane e nxiti Ministrinë e Luftës të Italisë të nxirrte një promemorie, më 7 prill 1939, për të kontrolluar kontingjentin e ushtarakëve shqiptarë në Itali<sup>6</sup>. Sipas kësaj promemorie, komandantët e reparteve, ku kishte shqiptarë, do të ushtronin “veprime bindëse” rreth procesit “të paqtimit” të Italisë në Shqipëri. Megjithatë, përkujtesa orientonte të veprohej me vendosmëri (con fermezza) kundrejt elementeve që kishin shfaqur ndjenja kundërshtimi. Ndjenja të tilla kundërshtimi u shfaqën hapur pas pushtimit. Mbi 200 veta ishte kontingjenti i ushtarakëve shqiptarë që lanë menjëherë shërbimin në regjimentet italiane<sup>7</sup>.

Në rrethana të tilla, komanda italiane e pushtimit ndërmori masa komplekse, por dhe të matura ndaj kuadrove dhe ushtarakëve shqiptarë, të përgatitur në Itali.

Që në ditët e para të pushtimit të Shqipërisë, u përjashtuan nga radhët e ushtrisë, oficerët që ishin nga Mati, duke i konsideruar si mbështetës të Mbretit Zog. Kjo dukuri, në mënyrë evidente u shpalos në radhët e kuadrove ushtarakë të Matit, të cilët e lidhën detyrën e çlirimit të

<sup>3</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 153, viti 1939, dos. 29, fl. 1-4. Lista e nxënësve të përjashtuar nga shkolla.

<sup>4</sup> *Po aty*, Fondi 152/2, viti 1939, dos. 30, fl. 59-81. Procesverbal nr. 4, datë 21 tetor 1939.

<sup>5</sup> Piero Crocioni, *Gli albanesi nelle forze armate italiane (1939-1943)*, Romë: Archivio Storico, SME, 2001, f. 13.

<sup>6</sup> Ufficio Storico, Stato Maggiore Esercito Italiano (më tej: US, SMEI), H-9, busta 4.

<sup>7</sup> Archivio Centrale dello Stato (ACS). Ministero degli Interni. Direzione Generale della Pubblica Sicurezza (PS), 1941, b.1/A.

Atdheut me rivendosjen e autoritetit të shtetit shqiptar, që ishte lidhur ngushtë me emrin e Ahmet Zogut.

Mbështetësit zogistë matjanë ishin të arrestuarit dhe të internuarit e parë të pushtuesit, si kundërshtarë të vendosur të tij. Të tillë ishin Mehmet Çupi dhe Xhemal Çupi nga katundi Lis, për të cilët u mor vendimi të internoheshin në Pistoja për 3 vjet se “ishin të rrezikshëm”<sup>8</sup>. Disa prej tyre, siç ishte Haxhi Kurti, u kthyen të vdekur në Shqipëri.

Shembulli i lartë i qëndrimit antifashist u bë ai i Shahin Toçit, student akademist, i cili kundërshtoi betimin ushtarak mbi flamurin italian. Për këtë qëndrim atdhetar shërbimet sekrete italiane e eliminuan.

Jo më pak domethënës ishte akti i Xhelal Çupit me shokë të tjerë studentë të Akademisë në Torino, që mbytën vaporin italian “Paganini”, i cili sillte armë e municione për forcat italiane në Shqipëri<sup>9</sup>.

Me gjithë organizimet dhe riorganizimet e forcave ushtarake shqiptare, të ndryshimit të varësisë së tyre nga njësitë italiane, të dislokuara në Shqipëri, dezertimi i forcave ushtarake shqiptare, mbeti një fenomen i përhershëm dhe shqetësues për pushtuesit italianë, i cili nuk mund të evitohet. Dezertuesit përbënin një potencial të fuqishëm në qëndresën antiitaliane të shqiptarëve.

Është me interes të vemë në dukje se, kontingjentet e dezertorëve, nga të gjitha llojet e armëve dhe të shërbimeve, përbënin bërthamën e përhershme të çetave të formuara në luftën kundër italianëve në muajt e parë të vitit 1943. Fenomeni i dezertimeve ishte tregues i dështimit të politikës italiane të integritit të forcave ushtarake shqiptare në Forcat e Armatosura Italiane. Edhe ato oficerë matjanë që vepruan në radhët e forcave italiane në Kosovë, gjatë sulmit kundër Jugosllavisë, në vitin 1941, ishin të vetëdijshëm se i shërbenin çështjes kombëtare, duke i çliruar bashkatdhetarët nga sundimi serbo-sllav, në rrethanat e Luftës së Dytë Botërore. Një pjesë e tyre kryen detyra në organet qeverisëse lokale në komuna të ndryshme të Kosovës, siç ishte Shaqir Çelo, Murat Pëllumbi, Ismail Hysa, Mehmet Bushi, Halit Kryekurti, Jakup Ismaili etj.<sup>10</sup> Madje, pikërisht për këtë, ata u zhgënjyen dhe u dëshpëruan thellë, kur, në Kosovë e viset shqiptare, u rikthyen forcat nacionalçlirimtare jugosllave të mbështetura nga forcat partizane shqiptare.

<sup>8</sup> *AQSh*, Fondi 152, viti 1939, dos. 30, fl. 36. Procesverbal 2 qershor 1939.

<sup>9</sup> *Po aty*, Fondi 161, viti 1940, dos. 1211, fl. 10, 14-15. Informacion i Këshilltarit të Përgjithshëm të Policisë, 2 korrik 1940.

<sup>10</sup> Ferit Këputa, *Matjanët në Luftën e Dytë Botërore*, Tiranë: “Ilar”, 2007, f. 23.

Përfshirja e një numri shqiptarësh në procesin e krijimit të “Shqipërisë së Madhe”, siç e quante pushtuesi bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, e frenoi qëndresën antiitaliane. Duke iu referuar këtij fakti, studiuesit janë shprehur se, “atë që nuk mund ta bënte më paraja, e bëri realizimi i ëndrrës nacionaliste”<sup>11</sup>. Bashkimi i pjesës më të madhe të Kosovës me Shqipërinë, është konsideruar nga ndonjë studiues shqiptar “jo i plotë nga vlera juridike ndërkombëtare edhe pse ishte i drejtë”<sup>12</sup>. Të kërkuar vlerësimin e ngjarjeve në një luftë botërore me normat juridike ndërkombëtare të një kohe paqësore ishte non sens, sepse vetë lufta ishte prishja e ekuilibrit të marrëdhënieve ndërkombëtare të vendosura më parë.

Në gjysmën e dytë të vitit 1941 dhe gjatë vitit 1942, krerë të nacionalistëve matjanë janë në lidhje me Mbretin Zog, në përpjekje për të organizuar qëndresën kundër pushtuesit. Më 15 gusht 1942 kolonel Hysen Selmani mori një letër nga Shqipëria, ku njoftohej se në Mat është bërë një mbledhje e gjerë, e nacionalistëve matjanë<sup>13</sup>.

Në këtë mbledhje ishte biseduar edhe për pjesëmarrjen e zogistëve në Konferencën e Pezës, për të cilën ishin caktuar personat. Çeta e Hysen Bozhiqit, e formuar në Klos, në korrik 1942, ishte çeta e parë nacionaliste në Mat. Në të bënin pjesë edhe Ibrahim Bozhiqi, Haki Fejza, Mustafa Kaçaçi e Beqir Minxhozi. Ndërkohë, veprimtaria e nacionalistëve matjanë kurorëzohet me aksionet e para kundër fashizmit siç ishte ai Vigut (8 shtator 1942) i Xheres së Celës (30 dhjetor 1942). Në këtë të fundit mori pjesë edhe çeta zogiste e Xibrit, e cila vepronte në bashkëveprim me atë të Abaz Kupit.

Për veprimtarinë e nacionalistëve matjanë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, patën rëndësi orientimet dhe qëndrimet politike të Mbretit Zog në mërgim. Duke ndjerë se kishte mbështetje nga shqiptarët në Turqi, Bullgari, Egjipt dhe ShBA, Mbreti Zog kishte shprehur një plan konkret për hapjen e një fronti nga Greqia kundër italianëve dhe, më tej, të organizonte një kryengritje të gjerë në të gjitha pjesët e Shqipërisë<sup>14</sup>.

<sup>11</sup> Roberto Morozzo della Rocca, *Shqipëria, rrënjët e krizës*, Tiranë: “Shtëpia e librit”, 2000, f. 94.

<sup>12</sup> Kristo Frashëri, “Nacionalizmi dhe demokracia në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore”, në *Rilindja Demokratike*, 17 nëntor 1992.

<sup>13</sup> “Dokumenti i Arkivit Mbretëror”, në *Korieri*, 16 shkurt 2003, f. 15; Hysen Selmani, *Nga notimet e Zogut I, Mbretit të Shqiptarëve*, Tiranë: 2008, f. 514.

<sup>14</sup> Foreign Office (F.O.) 371/24868/8270. Raport i A. Royan, Londër, 8 nëntor 1940.

Plani konsistonte në goditjen e prapavijave italiane në Shqipërinë e Veriut, ku Zogu kishte përkrahje më të madhe. Por, siç dihet, Greqia nuk e pranoi një plan të tillë, sepse politika greke ishte kundër rritjes së rolit të Mbretit Zog në qëndresën antifashiste, të cilin e shihte si pengesë për realizimin e synimeve aneksioniste ndaj Shqipërisë.

Nacionalisti Sali Llani ishte një nga ushtarakët e Mbretërisë Shqiptare që kishte marrë porosi nga Hysen Selmani, që të kthehej në Mat dhe të organizonte qëndresën antifashiste. Në qershor të vitit 1943, në fshatin Gurrë e Vogël, në shtëpinë e Sen Lezit, ai formoi çetën nacionaliste prej 80 vetësh. Çeta veprroi sidomos në zonën e Germanit, Frankthit, Batrës, Burrelit dhe të Suçit, ku do të luante një rol të rëndësishëm gjatë kryengritjes popullore të korrik-gushtit 1943.

Në verë të vitit 1943, ishin krijuar rrethana të favorshme për të kaluar në një fazë të re të organizimit e të zhvillimit të luftës antifashiste. Nga familjet e mëdha matjane, të njohura për atdhetarizëm, ishte krijuar edhe një elitë intelektualësh. Kështu, nga fisi i Sul Kurtit kishte rreth 14 oficerë e nënoficerë të shkolluar. I gjithë fisi, me në krye Sulën, u vunë në organizimin e kryengritjes popullore të Matit. Veç Sul Kurtit, në Kuvendin e Bruçit, të 26 korrikut 1943, morën pjesë Sali Llani, Beqir Minxhozi, Bilal Kola, Ismail Lala, Xhemal Lleshi, Din Ahmeti, Rustem Kogjuku, Hazis Kasemi si dhe përfaqësuesit e bajraqeve, Ndrec Lufi, Frrok Gjet Kola e Tahir Mena.

Midis problemeve të tjera, që u diskutuan në Kuvendin e Bruçit, u shtrua edhe çështja se në emër të kujt do ta bëjmë luftën, me synimin që lufta të kishte si rezultat logjik rivendosjen e sovranitetit të shtetit shqiptar të paraluftës, duke pasur parasysh Ahmet Zogun.

Pa u zgjatur në zhvillimin e kësaj lufte të mbarë matjanëve, dua të ve në dukje se kjo luftë, gjatë muajit gusht 1943, së bashku me luftën e Reçit (në Shkodër) përbëjnë një pikë kulmore të konfrontimit ushtarak italo-shqiptar, në prag të kapitullimit të Italisë në Shqipëri. Ajo ishte një provë e suksesshme e bashkëpunimit të të gjithë forcave politike shqiptare në krahinën e Matit. Këtu qëndron dhe rëndësia historike e saj. Vetë pushtuesi u kushtoi rëndësi të veçantë ngjarjeve të kësaj kohe në Mat e Dibër, duke i konsideruar ato si “çelësin e përhershëm të mbrojtjes së Shqipërisë”<sup>15</sup>.

---

<sup>15</sup> US.SMEI.DS. Anno 1943. B. 2278, fasc. 9. (Comanda della 9 Armata Ufficio I, Notiziario mensile, nr. 8 (mese di agosto), p. 3.

Rëndësia dhe madhështia e kësaj ngjarjeje historike është zbehur si rezultat i vlerësimit të saj vetëm nga pozita tendencioze politike. Ajo është shfrytëzuar për kapital politik, sipas koniunkturave dhe është mbështetur vetëm në modelimin e historisë sipas vijës politike të PKSH, pas denoncimit të Marrëveshjes së Mukjes. Sipas historiografisë komuniste, fillimisht, u kërkuan “argumente”, për të ngarkuar me përgjegjësi nacionalistët për prishjen e bashkëpunimit midis forcave politike. Për këtë qëllim, në Konferencën e Labinotit (shtator 1943), në diskutimet rreth Kryengritjes së Matit, (gusht 1943) u tha se, ajo kishte qenë e paorganizuar e pakoordinuar dhe pa rezultate. U bënë akuza për Parinë e Matit, se ajo u tërhoq dhe la frontin e luftës<sup>16</sup>. Për ta diskredituar parinë (kupto: nacionalistët), asaj iu faturuan edhe veprimet e grabitjes së dyqaneve e të magazinave të qytetit të Burrelit (!).

Ndërsa, në Kongresin e Përmetit (maj 1944), kur u shpall triumfi i vijës politike të PKSH, për marrjen e pushtetit, në diskutimet me referenca nga lufta, do të silleshin “fakte” që përlligjin fitoren e komunistëve. Prandaj, të njëjtët diskutantë ishin pjesëmarrës edhe në Konferencën e Labinotit, të shtatorit 1943, e trajtuan Kryengritjen Popullore të Matit, si vepër vetëm të çetës partizane të Matit. Duke përjashtuar pjesëmarrjen e Parisë dhe rolin e saj, në luftën e Matit, u trillua shpifja, sipas së cilës, roli i saj “kishte vetëm qëllim plaçkitjeje”.

Euforia e komunistëve për vendosjen e pushtetit të tyre, në gati gjysmën e Shqipërisë, inkurajonte delegatët e Kongresit të Përmetit, që, të gjitha ngjarjet historike, t’i trajtonin në funksion të kësaj “fitoreje”. Pikërisht, në këto vlerësime tendencioze politike, e kanë burimin ato qëndrime intrasigjente të PKSH, për shkallëzimin e luftës civile kundër nacionalistëve në Veri të vendit, ku ndeshi një qëndresë të vendosur antikomuniste të parisë së Matit. Thelbin e luftës së Divizionit I Sulmues të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, (qershor 1944) për asgjësimin e Bazit të Canës (Abaz Kupit) dhe të forcave nacionaliste matjane, e shprehte, më së miri, letra e Liri Gegës, drejtuar Miladin Popoviçit. “Kam frikë, - thoshte ajo, - se mos Divizioni i Parë po bëhet një divizion fluturues ... që të luftojë vetëm me reaksionarë dhe të harrojnë luftën me gjermanët,

---

<sup>16</sup> *AQSh/AP*, Fondi 40, viti 1943, dos. 12. procesverbalet në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare, Labinot 4-8 shtator 1943; B. Minxhozi, *Lufta Nacionalçlirimtare në Mat*, Tiranë, 2000, f. 135.

sepse grumbullime e postë gjermanësh nuk ka, rrugë kryesore komunikacioni nuk ka<sup>17</sup>.

Kundër nacionalistëve matjanë u zhvilluan masakra e reprezalje si në Qafë Shkallë, në Kurdari e Macukull. Në Kurdari u pushkatuan 15 veta që u gjetën në shtëpi ose rrugëve të fshatit dhe u dogj një lagje<sup>18</sup>.

Në këto rrethana, të epërsisë së Lëvizjes Nacionalçlirimtare, pushteti komunist u shtri me forcën e armëve në Mat dhe në gjithë Shqipërinë e Veriut. Në shënjestër të goditjes së pushtetit komunist ishin: familja e Sul Kurtit, e Sali Llanit, Selmanajt e Lisit, Vatajt në Macukull, familja e Bilal Kolës, fisi i Çelajve në Patin, Lezajve në Gurrë; i Allamanëve në Kurdari, i Xhetanëve të Derjanit, familja e Murat Bashës në Plan të Bardhë, fisi Cakoni në krahinën e Rrënxës, fisi i Hamit Çollakut në Fullqet, fisi Hoxhaj dhe Karaj në Gur të Bardhë etj. Nacionalistët matjanë u goditën, jo vetëm si të tillë, por edhe si mbështetës të Mbretit Zog, kundërshtari politik më i vendosur i regjimit komunist.

Duhet pranuar se një nga arsyet e fundit tragjik të nacionalistëve matjanë, duke mos përmbushur realizimin e aspiratës së tyre, rivendosjen e autoritetit të shtetit shqiptar të parapushtimit, ishte se ata nuk u organizuan dhe nuk bashkëpunuan me njeri-tjetrin, për t'iu përgjigjur stuhisë komuniste. Ata nuk patën dhe mbështetjen e duhur nga Aleatët e Mëdhenj Antifashist, të cilët paravendosën fatin e Shqipërisë në Konferencat ndërkombëtare, duke e lënë nën influencën e Titos. Nacionalistët matjanë u tradhtuan nga miqtë e tyre fillestarë, me të cilët kishin bashkëpunuar, që në fillim të luftës.

---

<sup>17</sup> *AQSh*, Fondi 14, viti 1944, dos. 91, fl. 13. Letër e Liri Gegës, 14 korrik 1944.

<sup>18</sup> *Po aty*, Fondi 14, viti 1944, dos. 53, fl. 45. Raport i Manush Myftiut, 5 gusht 1944.

